



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 784 , datë 26.12.2013

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.903, DATË 21.12.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN
E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI
I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER,
STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT
PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
 - "1. Përfitojnë bursë, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, studentët e pranuar në vitin e parë akademik, për çdo

program studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore mbi 9 (nëntë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Gjithashtu, përfitojnë bursë në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, studentët e regjistruar në çdo program studimi, në vitet pas të parit, me kriterin e notës mesatare mbi 9 (nëntë), të përlogaritur nga institucionet e arsimit të lartë, vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.”.

b) Aneksi 1, që i bashkëlidhur vendimit në fuqi, zëvendësohet me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

LINDITA NIKOLLA

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ARBEN AHMETAJ

ANEKSI 1

MASA E BURSËS PËR STUDENTËT NË IAL PUBLIKE

Nr.	Kategoritë e bursave	Totali mujor i bursës në lekë
1.	Universitetet dhe shkollat e tjera të larta	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë	10 000
	b) Gjysmëbursa akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë	5 000
2.	Universiteti i Sporteve	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin programe studimi në fushën e edukimit fizik, në të cilat parashikohet të kryhen orë praktikash sportive	10 000
	b) Gjysmëbursa akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë	5 000